



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
FIER

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM
NR. 65, DATË 04.09.2020

**“MBI RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET PROKURORËVE
DHE DREJTUESIT TË PROKURORISË, INFORMIMIN,
TRANSPARENCËN DHE GARANTIMIN E PAVARËSISË NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER”**

Në mbështetje të neneve 148, 148 shkronja “b”, “d”, “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 38 pikat 1 e 2 shkronjat “b”, “d”, “f”, 2 shkronjat “b” e “c”, 4,5,6,42 shkronja “a”, “c”, “g”, 43, 46, 47, 48, 50 e vijues të ligjit nr.97, datë 06.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë”, neneve 24, 25 pika 2 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, të nenit 52 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Rrepublicën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”:

URDHËZOJ:

**Neni 1
Qëllimi i udhëzimit**

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim të lehtësojë zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” lidhur me unifikimin e të drejtave dhe detyrimeve në ushtrimin e funksioneve të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, marrëdhëniet e tyre me drejtuesin e prokurorisë si prokuror më i lartë, informimin e koordinimin e veprimtarisë së prokurorisë, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Neni 2

Pavarësia e prokurorit, detyrueshmëria e ndjekjes penale

1. Prokurori ka pavarësi dhe autonomi në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e veprimeve procedurale, parashtrimin e kërkesave dhe marrjen e vendimeve në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm, i çdo autoriteti publik apo privat, gjatë hetimeve paraprake, përfaqesimit të akuzës dhe/ose çështjes në gjykatë dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale apo mbikëqyrjes të zbatimit tyre.

2. Pavarësia procedurale nuk e shmang prokurorin nga detyrimi për të përmbushur funksionet dhe/ose përgjegjësitë kushtetuese e ligjore që ka për të ushtruar ndjekje penale për çështjen që i ngarkohet dhe në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga prokurori më i lartë, me qëllim unifikimin e qëndrimeve në veprimtarinë e prokurorisë për çështje të caktuara, përfshire dhe zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave apo rezolutave të Kuvendit për luftën kundër kriminalitetit.

Neni 3

Ankimi kundër udhëzimit të përgjithshëm

1. Drejtuesi i Prokurorisë Fier mund të nxjerr udhëzime të përgjithshme të arsyetuara me shkrim të natyrës administrative ose procedurale të cilat janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët.

2. Prokurori, në rastet kur vlerëson se udhëzimi i përgjithshëm është i pabazuar në ligj, apo është haptazi në kundërshtim me ligjin, mund të bëjë ankim kundër udhëzimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, duke ndjekur procedurën si më poshtë: a) Ankimi i prokurorit kundër udhëzimit të përgjithshëm duhet të paraqitet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen e udhëzimit.

3. Prokurori është i detyruar të zbatojë udhëzimin e përgjithshëm të ankimuar prej tij, me përjashtim të rasteve kur ai vlerëson se udhëzimi është haptazi në kundërshtim me ligjin.

4. Drejtuesi i Prokurorisë kërkon fillimin e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe/ose hetimin disiplinor ndaj prokurorit në rastet kur ai nuk zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vepron haptazi në kundërshtim me ligjin apo vepron me keqdashje apo pakujdesi të rëndë në veprimtarinë procedurale të tij.

5. Prokurori kërkon fillimin e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme në rastet kur drejtuesi i prokurorisë, zëvendësdrejtuesi apo drejtuesi i seksionit nuk zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vepron haptazi në kundërshtim me ligjin apo vepron me keqdashje apo pakujdesi të rëndë në veprimtarinë procedurale të tij.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e prokurorëve në marrëdhëniet administrative me drejtuesin e prokurorisë

1. Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet administrative me drejtuesin e prokurorisë janë:

- a) Prokurori merr pjesë në çdo mbledhje të thirrur nga prokurori me i lartë përveç rasteve të justifikuara sipas ligjit apo me akte normative përkatëse. Dokumentimi i njoftimit në lidhje me mbledhjen bëhet nëpërmjet marrjes paraprake të nënshkrimit prokurorit nga nënpunësi i administratës i ngarkuar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Për ata prokuror për të cilët nuk është bërë e mundur marrja e nënshkrimit, do të bëhet komunikimi me telefon ose me e-mail me qëllim dokumentimin e njoftimit paraprak të tyre në lidhje me mbledhjen.
- b) Prokurori zbaton kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas ligjit dhe/ose me udhëzim të përgjithshëm në pjesëmarrjen në short apo në marrjen e një dosje/çështje që i është caktuar.
- c) Prokurori merr pjesë në çdo diskutim të natyrës profesionale të thirrur nga drejtuesi i prokurorisë dhe është pjese konstruktive e ketyre diskutimeve.
- d) Prokurori duhet të respektojë orarin zyrtar dhe të gjitha detyrimet administrative të parashikuara në ligj dhe me aktet normative detyruese përkatëse.
- e) Prokurori informon drejtuesin e prokurorisë për çdo veprimtari jashtë funksionit të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas ligjit.
- f) Prokurori ndihmon organet administrative të prokurorisë kur i kërkohet brenda kompetencave dhe funksionit të tij. Për çdo informacion për statistika që kërkohet nga drejtuesi, zëvendësdrejtuesi, shefi i seksionit dhe nga administrata, prokurori duhet t'i dorëzojë statistikat e tija të sakta dhe të plota brenda afatit të kërkuar.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e prokurorëve në marrëdhëniet procedurale me drejtuesin e prokurorisë

Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet procedurale me drejtuesin e prokurorisë janë:

- a) Prokurori udhëhiqet nga pavarësia e tij procedurale në kryerjen apo kontrollin e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale, perfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, ushtrimin e të drejtës së ankimit, urdhërimin dhe/ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale apo kryerjen e detyrave të tjera të caktuara me ligj.
- b) Prokurori në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur ka detyrimin të respektojë Kushtetuten, kuadrin ligjor të veprimtarisë, udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe/ose të drejtuesit të prokurorisë .
- c) Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara.
- d) Prokurori duhet të shmang çfarëdo lloj ndikimi dhe sjellje të paligjshme e të papërshtatshme që

cënon drejtësinë dhe imazhin e prokurorisë.

dh) Prokurori njofton drejtuesin e prokurorisë në rastet që konstaton se ka papajtueshmeri apo konflikt interesi të drejtëperdrejte ose të tërthorte me çështjen konkrete që ka në ndjekje apo në shqyrtim gjyqësor. Kërkesa paraqitet me shkrim.

e) Çdo marrëdhënie që lidhet me çështjen apo funksionet e tij si prokuror duhet të ushtrohet prej tij në rrugë institucionale.

f) Prokurori duhet të marrë pjesë në grupet e përbashkëta hetimore ose në procedime të lidhura në zbatim të ligjit dhe/ose planifikimit të bërë nga drejtuesi i prokurorisë.

Neni 6

Detyrimi për informim i drejtuesit të prokurorisë të Prokurorit të Përgjithshëm dhe detyrimi për informim i prokurorëve, OPGJ-ve dhe administratës të drejtuesi i prokurorisë në kuadër të informacioneve që kërkohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

1. Drejtuesi i prokurorisë, informon periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm me të dhëna të sakta mbi gjendjen e kriminalitetit dhe/ose për ecurinë e veprimtarisë në prokurorin që drejton, si dhe përgatit dhe dërgon raportin vjetor në formën dhe sipas treguesve të përcaktuar, raport i cili miratohet me urdhër të tij.

2. Lidhur me zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë, drejtuesi i prokurorisë raporton se si kanë ndikuar ato mbi gjendjen e kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë në fushat e rekomanduara. Në përgatitjen e këtyre raportimeve, drejtuesi i prokurorisë do të kërkojë sipas nevojave informacion prokurorëve, OPGJ-ve dhe administratës me qëllim për të raportuar të dhëna të sakta e të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe me elementë apo tregues të tjerë thelbësorë në veprimtarinë e prokurorisë.

Neni 7

Udhëzimet jo të detyrueshme të Drejtuesit të Prokurorisë, procedura e nxjerrjes dhe mbikqyrja e zbatimit të tyre.

1. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme për prokurorët e kësaj prokurorie, për kryerjen e veprimeve procedurale përpara se të merret vendimi për mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes konkrete.

2. Udhëzimet mund të nxirren nga Drejtuesi i Prokurorisë, në momentin e caktimit të kallëzimit penal apo referimit të veprës penale dhe/ose të procedimit/çështjes për ndjekje prokurorit, ose gjatë procesit të verifikimit të ecurisë së procedimit/çështjes, kur drejtuesi e vlerëson të nevojshëm për mbarëvajtjen apo mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes.

3. Udhëzimet jepen detyrimisht me shkrim dhe të arsyetuara.

4. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe brenda 48 orëve duhet të konfirmohen me shkrim.

5. Në rastet, kur prokurori i udhëzuar nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet e dhëna, brenda 5 (pese) ditëve ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtijshme për udhëzimet ose për pjesë të tyre.

6. Në këto raste, Drejtuesi i Prokurorisë, brenda 5 (pese) ditëve, është i detyruar të japë shpjegime me shkrim mbi udhëzimet dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr.

7. Në rastet kur prokurori, ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi me shkrim, vendos të mos e zbatojë udhëzimin e drejtuesit, ai duhet të njoftojë brenda 5 (pese) diteve me shkrim drejtuesin, duke arsyetuar shkaqet e moszbatimit të udhëzimit prej tij.

8. Udhëzimi me shkrim dhe përgjigjet e prokurorit i bashkëlidhen akteve të procedimit penal

Neni 8

Informimi i Drejtuesit të Prokurorisë nga Prokurori dhe Zyra e Regjistrimit të Prokurorisë

1. Zyra e regjistrimit në prokurori njofton drejtuesin e prokurorisë për çdo vendim për regjistrimin e procedimit penal të marre nga prokurorët. Informimi kryhet duke i dorëzuar drejtuesit kopje të urdhrave të regjistrimit, i cili pasi i lexon, bën ciklimin në këto urdhra lidhur me marrjen e tij dijeni dhe urdhëron zyrëne regjistrimit për arshivimin e tyre.

2. Prokurori informon drejtuesin e prokurorisë, sipas kërkesës së drejtuesit, mbi ecurinë dhe problemet e veprimeve të para hetimore në rastet e ngjarjeve të ndodhura përgjate kryerjes së gaditshmërisë dhe/ose mbi ecurinë e procedimit penal, përpara përfundimit të tij. Në këtë rast si kërkesa e Drejtuesit të Prokurorisë, ashtu edhe informacioni i Prokurorit bëhen me shkrim.

3. Në rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit, prokurori, mbi kërkesën e drejtuesit, duhet të informojë drejtuesin e prokurorisë për shkaqet dhe ecurinë e mëtijshme të hetimit brenda 5 (pese) diteve nga kërkesa. Në këtë rast si kërkesa e Drejtuesit të Prokurorisë, ashtu edhe informacioni i Prokurorit bëhen me shkrim.

4. Zëvendës drejtuesi i prokurorisë ose shefi i seksionit i deleguar, që është i gatshëm ose në kushtet e mungesës së Drejtuesit, duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë për çdo kërkesë drejtuar gjykatës lidhur me:

- a) arrestimet në flagrance, ndalimet, masat e sigurimit personal;
- b) masat e sigurimit pasuror;
- c) mjetet për kërkimin e provës (*kontrollat, përgjimet, etj*);
- d) sigurimin e provës;
- e) aktet drejtuar institucioneve të vuajtjes së denimit me burgim;

f) masat mjekesore apo shërbimeve policore, të cilat nënshkruhen nga zëvendësdrejtuesi i prokurorisë, në mungesë të drejtuesit të prokurorisë.

Në lidhje me të gjitha aktet e listuara më sipër, prokurorët do të bëjnë printimin e tyre në tre kopje, ku një kopje do t'i dorëzohet drejtuesit ose zëvendësdrejtuesit, si dhe shefit të seksionit në rast të autorizimit të tij nga drejtuesi gjatë mungesës së tij. Në rast se zyra e protokollit konstaton gjendjen e këtyre akteve në dy kopje, duhet të bëjë fotokopjimin e tyre në një kopje dhe t'ia dorëzojë drejtuesit, zëvendësdrejtuesit. Zëvendësdrejtuesi dhe shefi i seksionit bëjnë dorëzimin e këtyre akteve drejtuesit të prokurorisë në momentin që ai paraqitet në prokurori.

Neni 9

Informimi mbi masat e sigurimit personal dhe pasuror

1. Prokurorët, me qëllim që të mundësojnë drejtuesin për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr.97/2016, përveç rasteve kur urgjenca nuk e lejon, duhet të informojnë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë, sipas organizimit të brendshëm në prokurori, për procedimin penal ku do të nxirren:

- a) urdhra ndalimi;
- b) ose do t'i drejtohen gjykatës kërkesa për caktimin e masave të sigurimit “arrest ne burg”, “arrest ne shtepi”;
- c) kërkesa për aplikimin e sekuestrove preventive, konservative;
- d) apo për hetimin pasuror ku do të kërkohej aplikimi i masave ndaj pasurisë ne kuader të ligjit nr.10192/2009.

Për rastet e parashikuara në gjermën “a” dhe “b” njoftimi mund të bëhet verbalisht ose shkurtimisht me e-mail. Ndërsa për rastet e parashikuara në gjermat “c” dhe “d” njoftimi do të bëhet me informacion me shkrim.

2. Drejtuesi mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme brenda 1 (një) dite nga marrja e informacionit.

3. Drejtuesi i prokurorisë, për procedime penale ku janë vendosur masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, apo janë aplikuar sekuestroja preventive, konservative, apo për hetime pasurore ku janë aplikuar masa ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr.10192/2009, me qëllim nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, mundet që t'i kerkoje prokurorit në momentin e regjistrimit të procedimit penal, hetimit pasuror apo përgjatë hetimit penal apo pasuror, të informohet paraprakisht, por jo më vonë se 1 (një) muaj përpara përfundimit të afateve të paraburgimit, të sekuestros, apo masave ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr.10192/2019, për gjendjen e procedimit penal apo hetimit pasuror. Si kërkesa dhe informacioni bëhen me shkrim. Informacioni duhet të përmbajë:

- Veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit penal apo hetimit e gjykimit pasuror, pyetjen e të pandehurit ose të personit nën hetim

dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra, si dhe veprimet hetimore që priten të kryhen.

4. Drejtuesi mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e informacionit.

Neni 10

Informimi për ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale dhe hetimit pasuror

1. Prokurorët informojnë kryesisht drejtuesin e prokurorisë për ecurinë e procedimit penal apo hetimit pasuror jo më vonë se 20 dite përpara se të vendosin përfundimin e hetimeve, shpalljen e moskompetencës lëndore apo tokësore në një procedim penal apo të kërkojnë konfiskimin ose vendosin pushimin në çdo hetim pasuror, në rastet në të cilat drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme ose prokurorëve u është kërkuar sa më sipër nga Drejtuesi në momentin e regjistrimit të procedimit penal apo hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij.

2. Informacioni bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, të dhëna për personat nën hetim dhe veprat penale që hetohen, masat ndaj pasurisë dhe çështje të tjera me rëndësi.

3. Drejtuesi i prokurorisë mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme jo më vonë se 3 (tre) ditë nga marrja e informacionit.

Neni 11

Informimi për përfaqësimin e akuzës në gjyq

1. Në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me:

- a) deklarimin e fajësisë;
- b) cilësimin juridik të veprës;
- c) llojin e dënimit;

d) dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ose ligjit 10192/2009, prokurori brenda 3 (tre) ditëve nga dhënia e vendimit informon drejtuesin e prokurorisë për vendimin dhe faktin nëse do të ushtrojë apelim. Informimi bëhet shkurtimisht me shkrim nga prokurori.

e) Prokurori që ka ushtruar apelim kundër vendimit të gjykatës, në rastet kur pas shqyrtimit gjyqësor janë zbuluar prova ose rrethanat e reja që i shërbejnë rigjykimit të çështjes së ankimuar, duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë dhe sipas rastit përgatit shtesë ankimin, si dhe njofton prokurorin dhe/ose drejtuesin e prokurorisë pranë gjykatës që shqyrton ankimin.

Neni 12

Delegimi i kompetencave dhe informimi i zëvendësdrejtuesit në prokurori

1. Drejtuesi i prokurorisë njofton paraprakisht Prokurorin e Përgjithshëm për periudhën kohore të delegimit të kompetencave të tij zëvendësdrejtuesit, duke venë në dijeni dhe prokurorët në atë prokurori.

2. Në mungesë të drejtuesit të prokurorisë, prokurori është i detyruar t'i përgjigjet kërkesave të zëvendësdrejtuesit të parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8 të këtij udhëzimi.

3. Në mungesë të drejtuesit të prokurorisë, ZV/Drejtuesi i Prokurorisë, përvec të tjerave, ushtron edhe kompetencat e parashikuara nga neni 7 i këtij udhëzimi.

Neni 13

Qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore

1. Për të garantuar transparencën e marrëdhënieve dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga ligji nr.97/2016 dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të tij, qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore mes drejtuesit dhe prokurorëve në prokurori, do të kryhet përmes protokollimit në regjistrin e komunikimeve të brendshme, sipas modelit Lidhja Nr.1 bashkëlidhur, në zbatim të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Në regjistër do të pasqyrohen të gjitha komunikimet e brendshme mes drejtuesve dhe prokurorëve, që lidhen me sa vijon:

- a) kërkesën për informacion nga drejtuesi apo personi i deleguar në rastet e parashikuara nga ky udhëzim,
- b) dhënien e informacionit nga prokurori në rastet e parashikuara nga ky udhëzim,
- c) nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, përsëritjen e tyre me shpjegimet, nga drejtuesi i prokurorisë,
- d) kërkesën e prokurorit për shpjegime të mëtejshme nga drejtuesi i prokurorisë,
- dh) refuzimin e ndjekjes së udhëzimeve të drejtuesit të prokurorisë nga prokurori,

f) kalimin për firme tek drejtuesit të shkresave dhe akteve apo materialeve bashkëlidhur që i drejtohen gjykatës, për kërkesat që lidhen me:

- i. masat e sigurimit;
- ii. përgjimet;
- iii. sekuestron preventive, conservative;
- iv. sekuestron dhe konfiskimin në bazë të ligjit nr.10192/2009;
- v. pushimin e procedimit penal;

- vi. dërgimin për gjykim;
- vii. vënien në ekzekutim të vendimeve penale,

ë) kalimin për firmë tek drejtuesit të shkresave apo akteve dhe materialeve bashkëlidhur që lidhen me:

- i. pezullimin e procedimit penal;
- ii. shpalljen e moskompetencës lëndore ose tokësore;
- iii. njoftimet e palëve dhe viktimës për mosfillimin e procedimit penal,

f) kalimin tek prokurori të shkresave të firmosura nga drejtuesi, të parashikuara në gërmat "e" dhe " ë " te nenit 12 të këtij udhëzimi.

3. Prokurori ka detyrimin që çdo shkresë që do i percjellë për firmë drejtuesit si dhe aktet apo materialin hetimor bashkëlidhur, ta dorëzojë kundrejt firmës tek nëpunësi që mban regjistrin e komunikimeve të brendshme.

4. Nëpunësi i regjistrit, pasi protokollon në regjistër shkresën dhe materialin bashkëlidhur, ia kalon menjëherë drejtuesit të prokurorisë kundrejt firmës.

5. Drejtuesi i prokurorisë duhet të firmosë çdo shkresë percjellëse që lidhet me materialet kallëzuese, procedimet penale, verifikimet pasurore dhe procedimet pasurore jo më vonë se 48 orë nga protokollimi i saj në regjistrin e komunikimeve të brendshme dhe ia dorëzon nëpunësit të regjistrit kundrejt firmës.

6. Çdo akt apo material hetimor që i bashkëlidhet shkresës protokollohet së bashku me shkresën dhe qarkullon i pashkëputur nga ajo.

7. Nëpunësi i regjistrit pasi protokollon në regjistër dorëzimin nga drejtuesi i prokurorisë të shkresës dhe akteve apo materialeve bashkëlidhur, ia kalon ato menjëherë kundrejt firmës prokurorit.

8. Nëpunësi i regjistrit të komunikimeve të brendshme në prokurori mban përgjegjësi për rregullshmërinë e mbajtjes së këtij regjistri, ku rregullshmëria e mbajtjes së këtij regjistri mund të jetë vazhdimisht objekt kontrolli nga drejtuesi i prokurorisë ose një prokuror/nëpunës i autorizuar prej tij.

10. Për efekte të zbatimit të kësaj dispozite lidhur me detyrat e nëpunësit përkatës të administratës, caktohet Kryesekretarja Mirketa Ndreko.

Neni 14

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të percaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit dhe shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe/ose hetimit disiplinor ndaj prokurorit.

Neni 15

Zbatimi dhe mbikeqyrja

Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët dhe nëpunësit e administratës.

Drejtuesi i prokurorisë dhe prokurorët, informojnë për çdo rast të moszbatimit të këtij udhëzimi sektorin e monitorimit ne Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi me 7 shtator 2020 dhe i njoftohet prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës së kësaj prokurorie.
2. Kopje e këtij udhëzimi i njoftohet menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtorisë së Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore.

DREJTUESI I PROKURORISË

Violeta SHKURTA

